

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"NERTILA" Sh.p.k.

Sot, më date **23.09.2021**, ne te nenshkruarit:

- **Mimoza Greca** lindur ne Fier, me 23.03.1964, shtetas shqiptare, banues ne Lushnje, identifikuar me karten e identitetit me Nr. 034222372, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar.
- **Nertila Xhebexhiu** lindur ne Lushnje, me 20.03.1987, shtetase shqiptare, banues ne Lushnje, identifikuar me pasaporten me Nr. BF3673483, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar; ne përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, "*Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare*" kemi vendosur të themelojme një Shoqërine me Përgjegjësi të Kufizuar të emëruar "**NERTILA**" Sh.p.k. (më poshtë referuar si "Shoqëria"), duke nënshkruar këtë Akt Themelimi. Aktiviteti i kësaj Shoqërie do të rregullohet nga Statuti i saj, i cili është pjesë përbërëse e këtij Akti Themelimi dhe i bashkëngjitet si Shtojca 1.

Neni 1

Emri i Shoqërisë është: "**NERTILA**" Sh.p.k

Neni 2

(1) Selia e shoqërisë ndodhet në adresën:- Lagja "Xhevdet Nepravishta", rruga "Shetitorja Stadiumit", pasuria me nr.24/242-N3, zona kadastrale 8571, Bashkia Lushnje.

(2) Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon: *nertila@yahoo.it*
Shoqëria ka te drejte te hape dege apo filiale ne te gjithë territorin e Republikes se Shqiperise.

Shoqëria ka te drejte te hape dege apo filiale ne te gjithë territorin e Republikes se Shqiperise.

Neni 3


- Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë pa kufij dhe fillon qe prej dates se regjistrimit te saj ne Regjistrin e Shoqerive Tregtare ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

Objekti i veprimtarise se shoqerise

Neni 4

Shoqëria do të kryej aktivitetin e mëposhtëm :

- 1- Tregti me pakice artikuj industrial.
- Megjithate shoqëria ka te drejte qe te shtoje dhe te ndryshoje objektin e veprimtarise se saj me vendim te asamblese se ortakeve.



Neni 5

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100000 Lekë. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

1. Ortaku themelues Mimoza Greca : Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme prej 60000 leke që përbën 60 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.
2. Ortaku themelues Nerila Xhebexhiu : Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme prej 40000 leke që përbën 40 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kontributi i ortakëve do të jetë në para.

Neni 6:

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Shtimi ose pakësimi i kapitalit themelor mund të behet vetëm pasi Asambleja e ortakëve me shumicë e ka dekretuar këtë dhe për më tepër të gjithë ortakët janë të detyruar që ta repektojnë dhe të kontribuojnë në para ose në natyrë në bazë të vendimit të shumicës së asamblese.

Neni 7:

Transferimi i kapitalit

Kuatat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen përmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë.
- b) shitblerjes; (me të drejtën e parablerjes nga ana e ortakëve).
- c) trashëgimise;
- d) dhurimit;
- e) çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë ligjërisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, përsa nuk parashikohet ndryshe në statut.

Pjesët e kapitakit themeltare janë ligjërisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

Neni 8


Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme, kuorumi, marrja e vendimeve, përjashtimi nga e drejta e votës dhe të tjera modalitete për funksionimin e organit vendimmarres përcaktohen në statutin e shoqërisë.

Neni 9



Administrimi

Aministratore e shoqërise emerohet:

1. **Z. Mimoza Greca** lindur ne Fier, me 23.03.1964, shtetas shqiptare, banuës ne Lushnje , identifikuar me kartën e identitetit me Nr. 034222372, madhor me zotesi te plote juridike, per te vepruar, e zgjedhur per nje periudhe 5 vjecare me te drejte rizgjedhje. Kompetencat dhe përgjegjësitë e Administratorit jane te percaktuara qarte ne statutin e shoqërise.

Neni 10

Viti financiar-ekspertët

Viti financiar i shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përgjastimisht, viti i parë financiar fillon nga data e rregjistrimit në Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar pregatit raportin me shkrim për nxirjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cialt është i detyruar që tja paraqesë e ta dorëzojë në kohë ortakëve për ti shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

Neni 11

Prishja-riorganizimi i shoqërisë

Modalitetet per prishjen dhe riorganizimin e shoqërisë jane te percaktuara ne statutin e shoqërise në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i Ndryshuar.

Neni 12

Akti i Themelimit eshte hartuar ne 4 kopje origjinale.

ORTAKET E SHOQERISE

Mimoza Greca



Nertila Xhebexhiu

